

Diarreja e viçit mund të prekë të gjithë tufën

*Realizuar nga Franz Riegler, konsulent i Schaumann,
dhe aksioner i Austria Praemix shpk
Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka*



Diarreja është një sëmundje që prek çdo viç në çdo moshë. Në veçanti viçat e vegjël (kjo do të thotë viçat deri në moshë 3 deri në 4 javësh) sëmuren më shumë nga kjo sëmundje, ku ndodh që shumë dhe më pas të gjitha kafshët e fermës të preken prej saj.

Pa një trajtim të shpejtë dhe efektiv të viçave të vegjël, do të sillte si pasojë vdekjen e tyre ose në të kundërt do të kishim viça që nga sëmundja do të kishin një sistem imunitar të ulët dhe nuk do të merrnin veten tërësisht. Për një fermë me viça të prekur nga diarreja nuk është vetëm problemi i shpenzimeve financiare shtesë dhe kohore për furnizimin e kafshëve të prekura, por edhe humbja e viçave të vlefshëm mund të shkaktojë dëme serioze afatgjatë.

Informacion i përgjithshëm

Diarreja është një sëmundje e shkaktuar nga shumë faktorë, duhet të mblidhen disa shkaqe, që shkakojnë këtë sëmundje (Tab. 1). Pjesa më e madhe e këtyre faktorëve janë faktorë menaxherialë (që nuk kanë të bëjnë me faktorët e infeksionit) që ndikojnë më së shumti në diarrenë e viçave në ferma, lidhet direkt me përgatitjen e lopës për pjellje, (periudha e tharjes, vaksinimi i lopës) pjellja të realizohet në mjedis të pastër (ambjenti i pjelljes së viçave duhet të jetë i pastër dhe i sterilizuar, ndërhyrja e veterinerit gjatë pjelljes duhet të jetë e kujdesshme dhe higjienike) dhënia e shpejtë e kulloshtrës viçit të porsalindur (të paktën 2 x 2 litra për 12 orët e para të jetës) një ambient i pastër dhe i lirë, pa diskutim dhe higjienik për viçin e porsalindur dhe mbi nevojat e tij ushqimore , ushqyerja optimale duhet të përmbajë qumësht, ujë, bar dhe ushqim për viçat.

Gjatë menaxhimit gabojmë, si për shembull: mungesa e dhënies së kulloshtrës në kohën e duhur tek viçat e vegjël ose dhënia me vonesë e saj, mungesa e higjienës nxit shkaktarët patogjen që shkaktojnë diarrenë, gjë që rrit rrezikun që shkaktarët e diarresë (shkaktarë infektues) të shkaktojnë sëmundjen e viçave. Shkaktarët më të zakonshëm që shkaktojnë diarrenë tek vicat javët e para të jetës janë viruse (virusi Rota- korona), bakteret (variacione të shumta të E. Koli) dhe parazitë (Kriptosporidi). Të gjithë këta janë shkaktarët më të pranishëm, që janë shfaqur në kombinime të shumta nëpër ferma. Këto shkaktarë transmetohen zakonisht nga kafshët e vjetra të seleksionuara për skartim ose nga viçat e tjerë të sëmurë me diarre që ia transmetojnë viçave të rinj.

Faktorë jo infektues=Faktorë menaxherialë

Faktorë infektues

<p>Përgatitjen e lopës për pjellje -vaksinimi i lopës (E.koli, Rota- korona) -periudha e thatë (kulloshtra)</p> <p>Pjellja -ambjenti i pjelljes së viçave duhet të jetë i pastër dhe i sterilizuar -ndihma gjatë pjelljes me mjete të sterilizuara - për vicat me problem, të ndahet menjëherë nga nëna</p> <p>Përkujdesja për kulloshtrën</p> <p>Stalla -bokse individuale të pastruara dhe të sterilizuara deri në 3 javët e para të jetës -pastaj mbledhje deri në 6 viça në grup.</p> <p>Ushqyerja mbas fazës së kulloshtrës -masa e duhur e qumështit është 12 % e masës trupore e ndarë në disa vakte -maksimumi i qumështit për vakt është 2.5 litra -qumështi të jepet me NUGgi (ndihmon në refleksat e kanalit të faringut)</p> <p>Ushqyerja Rëndësi ka uji i pastër, qumështi, bari i freksët</p>	<p>Viruset Rota Korona</p> <p>Bakteret Variacionet e bakterit E.koli</p> <p>Parazitët Kriptospori</p>
--	--

Tabela Nr. 1: Shkaqet e sëmundjes

Zhvillimi i sëmundjes

Integriteti i zorrës së hollë dhe të trashë është i rëndësishëm për një tretje të mirë dhe një jashtëqitje normale. Cipa e mukozës së zorrëve është e përbërë nga vile të panumërta që nga njëra anë ndërtojnë substanca, të cilat zbërthejnë lëndët ushqyese dhe nga na tjetër asimilojnë keto lëndë ushqyese në organizmin tretës. Në zorrën e trashë, këto vile përthithin lëngjet dhe kjo sjell një trashje të jashtëqitjes. Ky ekuilibër do të prishej nëse funksioni i mukozës së zorrëve do të prekej ose kur përberja e zorrëve do të ndryshonte jashtë vileve të zorrëve jashtëzakonisht shumë dhe kjo për shëmbull do të sillte një përforsim të fluiditetit në vend të përthithjes.

Kur këta shkaktarë patogjenë të lartpërmendur gjenden në zorrët e viçave, na çojnë në mekanizma të ndryshëm të diarresë. Bakteri E.Koli prodhon një lëndë (Toksinë) e cila mbërrin në qelizat e mukozës të zorrëve dhe ndikon në rritjen e fluiditetit tek zorrët. Virusi rota- korona dhe paraziti Kriptosporidi shkatërrojnë qelizat e zorrëve që sjell një zvogëlim dhe një reduktim

të fluiditetit dhe të aftësisë së ruajtjes së vlerave ushqyese të ushqimit të tretur nga vilet. Këto procese të çojnë në një ndryshim të qëndrueshmërisë dhe të përbërjes së përmbajtjes së zorrëve. Fenomene të tilla na çojnë në precese të diarresë dhe nuk do të ketë përthithje të vlerave ushqyese.

Pavarësisht shkakut, kur viçin e zë diarreja humb shumë lëngje dhe kripëra (elektrolite). Ndikimi është që viçi nuk mund të përthithi vlerat ushqyese të ofruara nga ushqimi. Për sa kohë gjëndja e përgjithshme e viçit është e mirë, ai mund të pi për të kompesuar humbjet e shkaktuara nga diarreja me masa normale të qumështit, dhe ka mundësi për të pirë ujë dhe për të marrë kripërat. Është e rëndësishme që viçat të vazhdojnë të pijnë qumësht, kështu që ata mund të marrin yndyrën si një burim energjie dhe proteina për ndërtimin e indeve, si për shembull muskujt.

Kur gjëndja e përgjithshme e kafshës së sëmurë përkeqësohet dhe kur nuk thithin mjaftueshëm lëngje, sjell si pasojë në një kohë të shkurtër një deficit në lëngje dhe dukshëm viçi do të sëmuret. Një diarre e vazhdueshme ndikon në lodhje, sytë mbyllen dhe këtë e tregon një ecje e lodhur ose fakti që ka pak ose fare refleksin e gjirit.

Në diarre të rëndë viçat mund të humbin deri në 15% të peshës së tyre trupore, domethënë një viç prej 50 kg peshë mund të humbasë 7,5 L lëngje. Kafshët e tilla gjithmonë kanë nevojë për trajtim nga ana e veterinerit: humbjet e lëngjeve dhe elektroliteve dhe ndryshimet e rënda të gjakut (acidozës) mund të zgjidhen vetëm me infuzione. Ardhja në ndihmë tepër vonë, shkakton vdekjen e këtyre viçave nga mosqarkullimi i gjakut në zemër.

Masat parandaluese

Mundësitë, që ju keni për të parandaluar sëmundjen e diarresë tek viçat tuaj, i gjeni të listuara më poshtë, parimet e kulloshtrës . Një listë përfundimare të specifikimit të faktorëve të ndryshëm parandalues do të shpërndahet në kuadër të këtij raporti. Në parim problemet e diarresë do të adresohen në dy nivele. Në nivel të parë duhet që të merren masat që viçi ta marrë veten që mos të bie shumë shpejt pre e shkaktarëve të diarresë dhe së dyti të mbahen shkaktarët sa më larg.

Një mundësi tjetër e nënvlersuar dhe pamjaftueshëmrisht e përdorur për forcimin dhe mbrojtjen e viçit është furnizimi me kulloshtër. Kulloshtira përmban në oret e para të mjeljes një lëndë mbrojtëse (antikorpe) kundër shkaktarëve të infeksioneve. Këto antikorpe do të merren në 24 orët e para të jetës dhe ndikojnë direkt në zorrë dhe në gjak duke rritur imunitetin mbrojtës të viçit nga infeksionet deri sa ti krijohet sistemi imunitar aktiv. Mbas 24 orëve të para të jetës,

këto antikorpe nuk mund të arrijnë më në gjakun e viçit, ndonëse mund të neutralizojnë disa shkaktarë të ndodhur në zorrë.

Nëse keni pyetje të mëtejshme në lidhje me këtë temë ju mund të kontaktoni specialistët nga Austria Premix shpk, numër celulari 0684026311.

PARIMET E KULLOSHTRËS

Sasia

- ✓ Minimumi 4 L kulloshtër gjatë 12 ditëve të para ë jetës
- ✓ Për një vakt 2l kulloshtër gjatë 2 orëve të para të jetës
- ✓ Për dy vakte 2l kushtër gjatë 6-8 orëve të para të jetës

Cilësia

- ✓ Provoni cilësinë e kulloshtës me matësin e kulloshtëve
- ✓ Kulloshtër me cilësi të lartë ngrijeni në porcione me 500ml
- ✓ 500 ml të kulloshtës me cilësi mesatare bashkojeni me 500 ml të kulloshtës me cilësi të lartë

Koha e duhur

- ✓ 1 vakt maksimumi 2 orë
- ✓ 2 vakte maksimumi 6-8 orë

Përzierja korrekte

- ✓ Qumësht me kulloshtër dhe nugi i lejmë sëbashku
- ✓ Temperatura deri në 38-39 grad, të matet me termometër
- ✓ Kulloshtërën e ngirë të shkrihet ngadalë me ujë të ngrohtë